



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**Nr. 11/2018 regjistër (JR)
Datë 03.09.2018**

**Nr. 8 i vendimit
Datë 23.10.2018**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Luan Daci	Anëtar

mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 23.10.2018, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Hans Peter Kijlstra, me sekretare gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket ankimit:

ANKUESI:

Subjekti i rivlerësimit Luan Kaloçi, i përfaqësuar nga Avokat Ardian Visha, me prokurë nr. 3121 rep., me nr. 865 kol., datë 08. 06. 2018.

OBJEKTI:

Shqyrtimi i vendimit nr. 33, datë 05.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE:

Nenet 63, 64, 65, 66/b të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neni 52 i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 33, datë 05.07.2018, ka vendosur:

1. Shkarkimin nga detyra të z. Luan Kaloçi, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Apelit Tiranë.

2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

2. Ky vendim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) është marrë mbi shqyrtimin e dy pasurive/aseteve kryesore të deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë së tij, në vitin 2017. Konkretisht, pasuritë e shqyrtuara nga Komisioni janë si më poshtë:

A. *Apartament me sipërfaqe banimi 145 m², me vendndodhje Njësia Bashkiake Nr {***}, Tiranë.*

Për këtë pasuri, Komisioni ka bërë një hetim të thellë administrativ dhe në përfundim ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Luan Kaloçi nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të këtij aseti, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose evidentuar në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, bazuar në pikën 3 të nenit 61 dhe në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

B. *Hapësirë prej 132 m², sipas kontratës së datës 06.01.2003. E paregjistruar në hipotekë. Çmimi 5000.000 lekë.*

Edhe për këtë pasuri Komisioni ka bërë një hetim të thellë administrativ dhe në përfundim ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Luan Kaloçi nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të këtij aseti, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose evidentuar në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, bazuar në pikën 3 të nenit 61 dhe në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

Përfundimisht, Komisioni arsyeton në vendimin e tij se subjekti i rivlerësimit Luan Kaloçi:

- i. nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës;

- ii. referuar pikës 3 të nenit 61, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, pasi:
 - deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
 - ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - është kryer deklaram i rremë.
- iii. ka bërë fshehje të burimit të krijimit të pasurisë dhe deklarim të rremë në deklaratën e pasurisë “vetting” 2017, si dhe ka dhënë deklarime të rreme në shpjegimet e dhëna.

II. Shkaqet e ankimit

3. Kundër vendimit të mësipërm të Komisionit ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Luan Kaloçi nëpërmjet avokatit të tij, i cili kërkoi ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin në detyrë të subjektit, duke parashtruar këto shkaqe:
4. Vendimi i marrë nga Komisioni është rezultat i shkeljes së Aneksit të Kushtetutës, rezultat i një procesi të paragjykuar, si dhe rezultat i mosbërjes së një analize të hollësishme të provave që iu nënshtruan shqyrtimit gjyqësor të çështjes.
5. Procesi i rivlerësimit për subjektin Luan Kaloçi vetëm për kriterin e pasurisë është rrjedhojë e kuptimit dhe zbatimit të gabuar që Komisioni iu bën dispozitave kushtetuese dhe atyre ligjore që normojnë procesin e rivlerësimit. Procesi i rivlerësimit duhet të përfshijë kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, kjo për efekt të një procesi të rregullt ligjor. Gjykimi me një kriter, siç është ai i pasurisë për subjektin Luan Kaloçi, tregon për një proces të paragjykuar që në fillim. Përfundimi i procesit vetëm për një kriter e paragjykon atë, në kundërshtim kjo me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: “kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji.” Nisur nga interpretimi gramatikor dhe logjik, lidhëza “dhe” e përdorur nga ligjvënësi shteron mundësinë e përdorimit të kriterit objektiv të pamjaftueshmërisë pa u lidhur ky kriter si me figurën, ashtu edhe me pasurinë e subjektit. Si rrjedhojë, referimi që Komisioni bën në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 është i gabuar dhe i pabazuar në ligj dhe në Aneksin e Kushtetutës.
6. Komisioni duhet të verifikojë dhe të vlerësojë vetëm deklaratën e pasurisë “vetting” 2017, për efekt të këtij procesi. Nuk është kushtetuese që ai të mbajë përgjegjësi për deklaramet që ka bërë ndër vite. Për deklaramet ndër vite subjekti ka qenë objekt kontrolli ligjor nga ILDKPKI-ja. Pasaktësitë dhe parregullsitë në deklaramet e mëparshme janë trajtuar nga ligji i kohës. Për sa kohë që pasaktësitë e konstatuara në deklaramet e subjektit janë të pranuar nga ana e tij, ato nuk mund të konsiderohen si deklaram i rremë, pasi mungon dashja, lidhur me këto pasaktësi.
7. Parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (nenet 25, 27 dhe 28) ishin të tilla që i njihnin pasaktësitë dhe lapsuset (ato janë deklaram si të tilla nga subjekti) në deklaramet e pasurisë, madje deri në një vlerë prej 2.000.000 (dy milionë) lekësh në deklaramet periodike dhe 3.000.000 (tre milionë) lekësh në deklaramet për herë të parë. Për sa kohë që pasaktësitë e konstatuara janë pranuar nga subjekti i rivlerësimit, ato nuk mund të konsiderohen si deklaram i rremë, pasi mungon dashja apo qëllimi për të bërë deklaram të rremë, mungon gënjeshtër lidhur me pasaktësitë e konstatuara nga Komisioni, kjo nisur edhe nga bashkëpunimi që ka shfaqur subjekti gjatë gjithë procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, mungon dashja e subjektit për të kryer fshehje apo deklaram të rremë, e për pasojë nuk përbën sens realizimi i anës subjektive.

8. Për sa i përket mospërputhjes së deklarimeve të subjektit në çmim dhe në sipërfaqe të apartamentit të banimit, me sipërfaqe 145 m², i ndodhur në rr. {***} , Tiranë, janë thjesht gabime apo lapsuse njerëzore.
9. Lidhur me ambientin hapësirë prej 132 m², rruga “{***}”, në shumën 5,8 milionë lekë, deklarim i vitit 2003, dhe në deklarinimin për efekt të *vetting*-ut është deklaruar shuma 5 milionë lekë. Sa i takon burimit për blerjen e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit deklaroi se burimi është i ligjshëm. Pasaktësitë në deklarinim janë lapsuse apo pakujdesi nga ana e subjektit. Lidhur me lotarinë sportive në atë kohë, djali i subjektit ka qenë i mitur dhe nuk kishte ligj të specifikuar për ndalesën e të miturve. Lidhur me detyrimet që iu kishte shtetasve H.D. dhe B.XH., nuk janë detyrime që janë përdorur për blerje dyqani, por janë përdorur si garanci për nxjerrjen e vizës së vajzës A.K.. Dyshimi për mosshlyerje të këtyre detyrimeve është sqaruar në deklaratën që ka bërë subjekti në procesverbalin e deklarinimit, datë 18 janar 2016, para ILDKPKI-së.
10. Komisioni duhet t’i kalonte subjektit të rivlerësimit barrën e provës ose të hetonte rreth kontratave të ngjashme në tregun e shtëpive në Elbasan në momentin e shitjes së banesës. Në lidhje me vlerën e shitjes së apartamentit në Elbasan, subjekti pretendon se ajo është aq sa ka pohuar në deklaratën e vitit 2003, pra 4,8 milionë lekë. Ai mendon se vlera e përcaktuar në kontratë është lapsus i noteres, as që mendohej që një banesë e tillë të shitej për kohën në atë shumë.
11. Raporti i paraqitur nga ILDKPKI është raport i paracaktuar, është akt tendencioz dhe aspak profesional dhe nuk duhet të ishte marrë si provë në procesin e kontrollit dhe rivlerësimit të tij.
12. Nuk është kompetencë e ILDKPKI-së dhe as e Komisionit të shprehur për fiktivitetin ose pavlefshmërinë e kontratave (rasti i kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2000, me palë blerëse A.K. dhe palë shitëse shoqëria {***} SHPK), ajo është kompetencë vetëm e gjykatës.
13. Komisioni nuk duhet të ketë standard të dyfishtë në shqyrtimin e çështjeve, siç është rasti i dy anëtarëve të Gjykatës së Lartë (çështja D. dhe çështja Z.), çështjet e të cilëve u shqyrtuan menjëherë pas subjektit të rivlerësimit, me të njëjtët komisionerë dhe me të njëjtat problematika mbi lapsuse kontraktuale, të cilët u rikonfirmuan në detyrë nga Komisioni. Kjo është arsyeja që Komisioni po përdor standard të dyfishtë.
14. Pasuria që ka në pronësi dhe përdorim është rreth 12.000.000 lekë, ndërsa të ardhurat nga pagat e veta dhe të bashkëshortes, nga lotaria sportive, si dhe kredia e marrë janë shumë herë më të larta se pasuria që disponon.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

15. Trupi gjykues pasi shqyrtoi dhe analizoi në dhomë këshillimi të gjitha provat dhe faktet e administruara në dosje nga Komisioni, shkaqet e parashtruara në ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet avokatit të tij dhe, pasi e bisedoi çështjen në tërësi, arsyetoi si më poshtë:
16. Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Luan Kaloçi ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Apelit Tiranë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
17. Duke qenë se Luan Kaloçi është kandidat për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi.

Komisioni, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Luan Kaloçi, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

18. Subjekti i rivlerësimit Luan Kaloçi ka qenë subjekt deklarues pasurie prej vitit 2003 dhe deri në vitin 2017 (*vetting*).
19. Në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit Luan Kaloçi në deklarimin e tij ka paraqitur këto pasuri dhe të ardhura:
 - i. Një shtëpi banimi me sip. 92 m², 2+1, e blerë në vitin 2000, në shumën 4,2 milionë lekë, pjesa që zotëron 50%, me adresë rr. {***}, Tiranë. Burimi: Shitur banesën në Elbasan, e përfutur nga privatizimi në shumën 4,8 milionë lekë.
 - ii. Një dyqan të blerë në vitin 2003 në shumën 5,8 milionë lekë, me sipërfaqe 86 m², pjesa që zotëron 50%, me adresë rr. "{***}". Burimi: Nga lotari sportive "{***}", në vitin 2003.
 - iii. Të ardhurat e deklaruara në *CASH* janë në shumën 1,1 milionë lekë dhe detyrime 1,5 milionë lekë për blerje dyqani, marrë borxh shtetasit H.D. dhe 0,7 milionë lekë shtetasit B.XH., edhe këto me qëllim blerje dyqani.
20. Në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
 - i. Likuiditete në shumën 350.000 lekë, periudha e krijimit janar-dhjetor të vitit 2004.
21. Në vitin 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
 - i. Para *CASH* në shumën 160.000 lekë.
 - ii. Shtëpi banimi apartament 3+1, me sipërfaqe 125 m², shuma 55.000 euro. Nuk ka burim të deklaruar. Detyrim ka paraqitur kredi në Bankën Amerikane në shumën 55 mijë euro. Kredi e marrë në muajin qershor 2005.
22. Në vitin 2006, subjekti ka deklaruar:
 - i. Të ardhurat e subjektit nga paga si prokuror Apeli dhe të bashkëshortes si punonjëse e Gjykatës së Apelit Tiranë. Si detyrim paraqet kredinë e marrë në vitin 2005 dhe shuma e shlyer për një vit rezulton të jetë në 6.000 euro. Gjendja e detyrimit është 46.000 euro.
23. Në vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
 - i. Shumën 6.000 \$. Burimi: Nga kursimet e tij.
 - ii. Shumën në vlerën 960.000 lekë. Burimi: Nga të ardhurat e dyqanit.
 - iii. Shumën e detyrimit të mbetur nga kredia e marrë është 42 mijë euro.
24. Në vitin 2008, subjekti ka deklaruar:
 - i. Shumën 650.000 lekë. Burimi: Kursime nga viti 2008.
 - ii. Shumën 720.000 lekë. Burimi: Të ardhura nga qiraja e fituar nga ambientet e dhëna me qira shoqërisë "{***}" SHPK. Detyrimi i mbetur është në shumën 48 mijë euro.
25. Në vitin 2009, subjekti ka deklaruar:
 - i. Shumën 4.000 euro. Burimi: Llogari bankare në bankën Credins. Kursime familjare.

- ii. Shumën 10000 dollarë amerikanë. Depozitë në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT) në emër të bashkëshortes. Kjo shumë është marrë nga motra e bashkëshortes dhe është kthyer në një kohë shumë të shkurtër.
 - iii. Shumën 300.000 lekë. Burimi: Kursime familjare.
 - iv. Shumën 720.000 lekë, të ardhura nga qiraja e lokalit, e deklaruar më parë.
 - v. Detyrimin 25.000 euro të mbetur nga kredia e marrë për blerje të shtëpisë (këtu rezulton për një vit është shlyer shuma 23 mijë euro).
- 26.** Në vitin 2010, subjekti ka deklaruar:
- i. Mbylljen e depozitës në shumën 4 mijë euro.
 - ii. Shumën 8.000 euro. Burimi: Kursime nga pagat dhe qiratë në vitin 2010.
 - iii. Shumën 720.000 lekë të ardhura nga qiraja e lokalit, të deklaruar më parë.
 - iv. Detyrimin 21.220 euro nga kredia e marrë për blerje banese (rezulton për një vit ka paguar 1.780 euro). Në formularin e deklarimit sqaron se ka paguar 4.080 euro.
- 27.** Në vitin 2011, subjekti ka deklaruar:
- i. Shumën 11.000 euro *CASH*. Burimi: Kursyer gjatë vitit 2010 dhe të ardhurat familjare në vitin 2011.
 - ii. Shumën 720.000 lekë. Burimi: Të ardhura nga qiraja.
- 28.** Në vitin 2012, subjekti ka deklaruar:
- i. Gjendjen *CASH* 450.000 lekë. Burimi: Nga kursimet familjare.
 - ii. Shumën 21.000 euro, detyrim i mbetur nga kredia e marrë për blerje banese (subjekti sqaron se nga viti i kaluar ka paguar 3.900 euro në një kohë që vlera e detyrimit është pothuajse e njëjtë nga viti paraardhës).
- 29.** Në vitin 2013, subjekti ka deklaruar:
- i. Shumën 450.000 lekë. Burimi: Kursime familjare.
 - ii. Shumën 600.000 lekë të ardhura nga paga e djalit.
 - iii. Shumën 22.000 euro, detyrim i mbetur nga kredia për blerje banese.
- 30.** Në vitin 2014, subjekti ka deklaruar:
- i. Shumën 650.000 lekë. Burimi: Kursimet familjare.
 - ii. Shumën 303.102 lekë të ardhura nga paga e djalit.
 - iii. Shumën 18.600 euro, detyrim nga kredia e mbetur.
- 31.** Në vitin 2015, subjekti ka deklaruar:
- i. Një automjet në shumën 4.000 euro. Blerë në emër të djalit E.K.. Burimi: Kursime familjare.
 - ii. Shumën 23.000 lekë. Burimi: Nga kontrata e qirasë e ambientit të ndodhur në rrugën “{***}”.
- 32.** Në vitin 2016, subjekti ka deklaruar:

- i. Shumën 0 (zero) lekë në llogaritë rrjedhëse në emër të subjektit, bashkëshortes së tij dhe në emër të djalit të tij.
- ii. Shitjen e autoveturës në shumën 4.000 euro.
- iii. Shumën 3.500 euro për blerjen e automjetit Benz.
- iv. Shumën 12.000 euro për blerje garazhi me sipërfaqe 13,37 m², sipas kontratës 02.06.2016. Burimi i krijimit: Kursime familjare.
- v. Shumën 650.000. Kursime familjare.
- vi. Shumën 264.000 lekë të ardhura nga qiraja e ambientit.
- vii. Shumën 24.343 euro e detyrimit të mbetur nga marrja e kredisë për blerje banese.

33. Në vitin 2017, subjekti në deklaratën e pasurisë ka deklaruar:

- i. Një apartament me sipërfaqe banimi 145 m², me vendndodhje Njësia Bashkiake Nr{***} , Tiranë. Shuma e apartamentit është 52.000 dollarë amerikanë. Burimi: Blerje sipas kontratës së datës 26.04.2005. Ky apartament është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Tiranë, me numrin hipotekor {***} . Kjo shumë është rezultat i kredisë të marrë pranë Bankës Amerikane (sot Intesa San Paolo).
- ii. Një hapësirë 132 m², sipas kontratës datë 06. 01.2003, në shumën 5.000.000 lekë. Shitje e banesës në Elbasan, në këmbim të një banese në Skrapar të cilën e ka fituar me ligjin për privatizimin e banesave shtetërore.
- iii. Një garazh me sipërfaqe 13,37 m², në emër të djalit E.K., regjistruar në hipotekë nr. {***} , Tiranë, në shumën 12.000 euro.
- iv. Një automjet tip “Ford”, i blerë në vitin 2015. Burimi: Blerë sipas kontratës së datës 12.11.2016, në shumën 4.000 euro. Kursime familjare.
- v. Një automjet tip “Benz” në vlerën 3.500 euro. Burimi: Nga shitja e automjetit tip “Ford”.
- vi. Shumën 10.000 euro. Burimi: Kursime familjare.
- vii. Shumën 24.343 euro, detyrim i mbetur nga kredia e pashlyer, marrë në Bankën Amerikane (sot Intesa San Paolo).

34. Komisioni në vendimin e tij ka marrë parasysh shqyrtimin e dy pasurive, të cilat janë të deklaruara në deklarinimin e pasurisë (*vetting*) 2017.

Duke analizuar pasurinë e parë që ka deklaruar subjekti i rivlerësimit Luan Kaloçi në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, ku bëhet fjalë për një apartament me sipërfaqe banimi 145 m², me vendndodhje: Njësia Bashkiake Nr{***} , Tiranë, trupi gjykues pasi analizoi dhe krahasoi deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 dhe deklarinimet e tjera periodike, konstaton se:

- Vlera e deklaruar për këtë pasuri nga subjekti Luan Kaloçi ka qenë në vitin 2003 vlerën 4,2 milionë lekë. Në vitin 2005 subjekti ka deklaruar vlerën 55.000 euro dhe në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 ka deklaruar vlerën 52.000 dollarë amerikanë, ndërkohë që kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.03.2005, parashikon si çmim shitjeje vlerën 1.500.000 lekë.
- Burimi i deklaruar për këtë pasuri nga subjekti Luan Kaloçi ka qenë, në vitin 2003 shitja e shtëpisë në Elbasan, të cilën e kishte të përfutur nga privatizimi në shumën 4,8 milionë lekë. Në deklarinimin e pasurisë të vitit 2005 dhe në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 subjekti i

rivlerësimit ka deklaruar si burim të kësaj pasurie kredinë e marrë përmes kontratës së kredisë, të datës 26.04.2005, në ish-Bankën Amerikane, sot Banka Intesa San Paolo.

- Të dhënat e pasurisë. Subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri ka deklaruar në vitin 2003: Shtëpi banimi 2+1, sipërfaqen 92 m², rruga “{***}”. Në vitin 2005 subjekti ka deklaruar shtëpi banimi (apartament) 3+1, me sipërfaqe 125 m², kurse në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, subjekti ka deklaruar apartament me sipërfaqe 145 m², rruga “{***}”.

35. Lidhur me deklaratimet sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzion se, referuar deklaratimeve në vite të ndryshme për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar çmime të ndryshme të blerjes. Referuar burimit të krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton se janë deklaruar burime të ndryshme të krijimit të kësaj pasurie ndër vite. Gjithashtu, referuar të dhënave të kësaj pasurie trupi gjykues konstaton se subjekti nuk është i saktë në deklaratimet e tij lidhur me sipërfaqen e kësaj prone dhe adresën e saj. Referuar edhe analizës ekonomike, subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2003, i cili është deklaruar në vlerën 4,2 milionë lekë.
36. Sa më sipër, trupi gjykues arsyeton se subjekti i rivlerësimit Luan Kaloçi për këtë pasuri ka kryer deklaratim të rremë. Duke iu referuar deklaratimeve të tij periodike ndër vite, ka mospërputhje mes deklaratimeve, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, si dhe subjekti ka kryer fshehje të pasurisë, kjo referuar mospërputhjes mes deklaratimit për shitjen e banesës në Elbasan (subjekti deklaroi se e ka shitur 4,8 milionë) dhe çmimit të shitjes në kontratën me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.07.1999, që është 200.000 lekë, si dhe në kontratën e shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.03.2005, mes subjektit të rivlerësimit dhe shitësit A.K. çmimi është 1.500.000 lekë, kurse vlera e objektit të deklaruar është 52 mijë dollarë amerikanë.
37. Lidhur me deklaratimet sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, referuar deklaratimeve në vite të ndryshme, për këtë pasuri janë deklaruar çmime të ndryshme blerjeje. Referuar burimit të krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton se janë paraqitur burime të ndryshme të krijimit. Gjithashtu, referuar të dhënave të kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk është i saktë në deklaratimet e tij lidhur me sipërfaqen e kësaj prone dhe adresën e saj.

Provat në të cilat trupi gjykues mbështet arsyetimin e tij janë si më poshtë:

- i. Shkresa e ZVRPP-së Tiranë nr. 45851/1 prot., datë 11.01.2018, sipas së cilës konfirmohet e regjistruar në emër të z. Luan A. Kaloçi pasuria me nr. {***}, v. 24, f. 60, {***}, lloji i pasurisë apartament, me sipërfaqe 145,00 m².
- ii. Kontrata e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.03.2005, mes palës shitëse A.K. dhe palës blerëse Luan Kaloçi, sipas së cilës apartamenti i ndodhur në katin e shtatë, me sip. 145,3 m², i ndodhur në {***}, me nr. pasurie ***, në rr. “{***}”, shitet në vlerën 1.500.000 lekë.
- iii. Shkresa e OSHEE-së nr. 28040/1 prot., datë 12.01.2018, sipas së cilës konfirmohet në emër të Luan Kaloçit kontrata me nr. {***}, me status aktiv, në adresën rr. “{***}”, te Tregu Fshatar, pallati i ri, me datë hapjeje 16.10.2000.
- iv. Kontrata e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2000, sipas së cilës kjo pronë është blerë nga shtetasi A. K. prej shoqërisë {***} SHPK, me një çmim prej 1.990.000 lekësh.
- v. Shkresat e Bankës “Intesa Sanpaolo” nr. 18/7923/1 pot., datë 22.02.2018 dhe nr. 1764269/1 prot., datë 08.01.2018, nga ku rezulton një transfertë në vlerën 55.000 euro më datë 05.05.2005, me përfitues A.K..

- vi. Deklarata e pasurisë (*vetting*) 2017, ku deklarohet apartament me sipërfaqe 145 m², blerë sipas kontratës datë 26.04.2005, në vlerën 52.000 USD. Burimi: Kredia e marrë pranë Bankës Amerikane (sot “Intesa Sanpaolo”).
 - vii. Deklarata e pasurisë 2003, ku subjekti deklaroi shtëpi banimi, 2+1, e blerë në vitin 2000 në shumën 4,2 milionë lekë, me sipërfaqe 92 m², e ndodhur në rr. “{***}”, p. 24/1, ap. 11, Tiranë. Burimi: Shitja e shtëpisë në Elbasan në shumën 4,8 milionë lekë, e përfituar nga privatizimi.
 - viii. Deklarata e pasurisë e vitit 2005, ku subjekti deklaroi shtëpi banimi, apartament 3+1, sip. 125 m², në shumën 55 mijë euro.
 - ix. Deklarata e nënshkruar nga A.K., sipas së cilës ai deklaroi se me kërkesën e tij në kontratë u përcaktua vlera e shitjes prej 1.500.000 lekësh, por vlera reale e shitjes ka qenë 52.000 USD.
38. Pasuria e dytë që ka deklaruar subjekti Luan Kaloçi në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, është një hapësirë prej 132 m², sipas kontratës së datës 06.01.2003, e cila është e paregjistruar në hipotekë, me vlerë 5.000.000 lekë, rruga “{***}”, Tiranë.

Trupi gjykues, pasi analizoi dhe krahasoi deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 dhe deklaratimet e tjera periodike të subjektit, konstaton se:

- Vlera e deklaruar për këtë pasuri nga subjekti Luan Kaloçi ka qenë 5,8 milionë lekë në vitin 2003. Në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 subjekti ka deklaruar vlerën 5 (pesë) milionë lekë.
 - Burimi i deklaruar për këtë pasuri nga subjekti Luan Kaloçi në vitin 2003 ka qenë nga lotaria sportive “{***}”, ndërsa në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 subjekti ka deklaruar si burim të kësaj pasurie shitjen e banesës në Elbasan, në këmbim të një banese në Skrapar, të cilën e ka fituar me ligjin për privatizimin e banesave shtetërore.
 - Të dhënat e pasurisë. Subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri ka deklaruar: Dyqan blerë në vitin 2003, me sipërfaqe 86 m², rruga “{***}”, kati i parë. Ndërkohë, në deklarimin e pasurisë (*vetting*) 2017, subjekti për këtë pasuri ka deklaruar hapësirë prej 132 m², sipas kontratës së datës 06.01.2003.
39. Lidhur me deklaratimet sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, referuar deklaratimeve në vite të ndryshme, për këtë pasuri janë deklaruar çmime të ndryshme blerjeje. Referuar burimit të krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton se janë paraqitur burime të ndryshme të krijimit. Gjithashtu, referuar të dhënave të kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk është i saktë në deklaratimet e tij lidhur me sipërfaqen e kësaj pasurie. Referuar kontratës mes sipërmarrësit V.P. dhe bashkëshortes së subjektit, vlera e kësaj kontrate është zero, pasi rezultoi e dhuruar. Vlera e kësaj pasurie, e deklaruar në vitin 2003, ka mospërputhje me vlerën e deklaruar në vitin 2017. Trupi gjykues konstaton se subjekti ka mungesë të burimit të ligjshëm për të justifikuar këtë pasuri.
40. Kolegji arsyeton se subjekti i rivlerësimit Luan Kaloçi për këtë pasuri ka kryer deklaratim të rremë. Duke iu referuar deklaratimeve të tij periodike ndër vite, ka mospërputhje mes deklaratimeve, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, si dhe ka kryer fshehje të pasurisë. Trupi gjykues e mbështet këtë arsyetim në provat si më poshtë:
- i. Kontrata sipërmarrjes, datë 06.01.2003, mes sipërmarrësit V.P. dhe porositësit L.K., me objekt prenotimin nga pala porositëse të një dyqani të ndodhur në katin përdhe, me sipërfaqe 132 m², sipas së cilës, referuar neneve 2 dhe 3 të saj, rezultoi se sipërmarrësi V.P. ia ka dhuruar këtë dyqan porositëses, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.
 - ii. Shkresa e OSHEE-së nr. 28040/1 prot., datë 12.01.2018, sipas së cilës konfirmohet në emër të

L.K. një kontratë e furnizimit me energji elektrike me nr. {***} , me adresë në rr. “{***} ”, që nga data 24.02.2005.

iii. Shkresat e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë me nr. 1006 prot., datë 08.01.2018 dhe nr. 1006/2 prot., datë 29.01.2018, sipas së cilave konfirmohet se L.K. ka të regjistruara 2 pjesë (44 m² dhe 88 m²) të një prone me sip. 132 m², me adresë rr. “{***}”, të regjistruara në kohë të ndryshme.

iv. Sqarimet e dhëna në ILDKPKI më datë 18.01.2016 dhe datë 16.02.2016, ku subjekti i rivlerësimit sqaron se pavarësisht se të dyja huat janë deklaruar si të marra për blerjen e dyqanit, realisht janë përdorur si garanci për studimet e vajzës në Itali. Këto hua janë marrë dhe janë shlyer brenda vitit.

v. Deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017.

vi. Deklaratat e pasurisë të subjektit të rivlerësimit për vitin 2003.

41. Lidhur me shkaqet në ankim të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues arsyeton:

Vendimi i marrë nga Komisioni është rezultat i shkeljes së Aneksit të Kushtetutës, rezultat i një procesi të paragjykuar, si dhe rezultat i mosbërjes së një analize të hollësishme të provave, të nënshtruara shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

Lidhur me këtë shkak që pretendon subjekti nëpërmjet avokatit të tij, trupi gjykues vlerëson se provat që janë administruar në dosje, janë analizuar në mënyrë të tillë që nuk është shkelur asnjë dispozitë e Aneksit të Kushtetutës. Provat janë trajtuar në harmoni me njëra-tjetrën dhe Komisioni ka dalë në konkluzion të drejtë.

42. Procesi i rivlerësimit për subjektin Luan Kaloçi vetëm për kriterin e pasurisë, është rrjedhojë e kuptimit dhe e zbatimit të gabuar që Komisioni iu bën dispozitave kushtetuese dhe atyre ligjore që normojnë procesin e rivlerësimit. Në vlerësimin e trupit gjykues, procesi i rivlerësimit duhet të përfshijë kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, kjo për efekt të një procesi të rregullt ligjor. Gjykimi me një kriter, siç është ai i pasurisë për subjektin Luan Kaloçi, tregon për një proces të paragjykuar që në fillim nga Komisioni. Përfundimi i procesit vetëm për një kriter e paragjykon atë, në kundërshtim kjo me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: “kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji.” Nisur nga interpretimi gramatikor dhe logjik, lidhëza “dhe”, e përdorur nga ligjvënësi shteron mundësinë e përdorimit të kriterit objektiv të pamjaftueshmërisë pa u lidhur ky kriter si me figurën, ashtu edhe me pasurinë e subjektit. Si rrjedhojë, referimi që Komisioni bën në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 është i gabuar dhe i pabazuar në ligj dhe aneksin e Kushtetutës.

Sipas trupit gjykues të Kolegjit, vendimi i Komisionit është në përputhje me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili shpreh qartë se Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave. Në bazë të këtij parashikimi ligjor, Komisioni ka filluar hetimin administrativ për të tria kriteret e vlerësimit. Gjatë këtij hetimi, Komisioni pasi ka vlerësuar se ka hetuar në mënyrë të plotë kriterin e pasurisë, bazuar në provat e grumbulluara dhe vlerën e tyre provuese, ka arritur në përfundimin se vlerësimi i subjektit të rivlerësimit mund të bëhej edhe vetëm për këtë kriter, pa qenë nevoja e përfundimit të hetimit të plotë edhe të dy kriterëve të tjera. Përfundimi i procesit të

rivlerësimit vetëm për një kriter nuk e paragjykon atë, pasi subjektit të rivlerësimit i është dhënë mundësia për të paraqitur argumentet e tij kundërshtuese gjatë fazës së hetimit administrativ, si dhe për t'u dëgjuar në mënyrë të drejtë edhe gjatë seancës dëgjimore publike.

Në vijim, theksojmë se në interpretim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ndryshe nga ajo që pretendon ankuesi, nuk është e nevojshme që pamjaftueshmëritë në deklarin për kontrollin e pasurisë dhe të figurës të ekzistojnë në mënyrë kumulative për të konkluduar me vendimmarrjen për shkarkim nga detyra.

Neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”. Duke interpretuar dispozitat e mësipërme në mënyrë sistematike, Komisioni dhe Kolegji kanë të drejtë për të konkluduar me vendim qoftë edhe vetëm për njërin nga kriteret, dhe bazuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, për kriterin e pasurisë, Kushtetuta parashikon shkarkimin nga detyra edhe për ato raste të deklarin të pasurisë të parashikuara në këtë dispozitë, siç është përpjekja për të fshehur apo paraqitja në mënyrë të pasaktë e pasurive.

43. Komisioni duhet të verifikojë dhe të vlerësojë vetëm deklaratën e pasurisë “vetting” 2017, për efekt të këtij procesi. Nuk është kushtetuese që ai të mbajë përgjegjësi për deklarinet që ai ka bërë ndër vite. Për deklarinet ndër vite, subjekti ka qenë objekt kontrolli ligjor nga ILDKPKI-ja. Pasaktësitë dhe parregullsitë në deklarinet e mëparshme janë trajtuar nga ligji i kohës. Për sa kohë që pasaktësitë e konstatuara në deklarinet e subjektit janë të pranuar nga ana e tij, ato nuk mund të konsiderohen si deklarin i rremë, pasi mungon dashja, lidhur me këto pasaktësi.

Kolegji shqyrton deklaratat e subjektit të rivlerësimit për të shkuarën e tij, interviston personat e përmendur në deklaratë ose persona të tjerë, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore ose të huaja për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarinëve. Kjo është e parashikuar në Kushtetutë, konkretisht në Aneksin e saj, neni Ç, pika 4, si dhe në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Rivlerësimi nuk mund të bëhet pa bazë krahasimore mes deklarinëve periodike dhe deklarin të pasurisë “vetting” 2017. Ballafaqimi i deklarinëve periodike me atë të bërë për efekt “vetting” në vitin 2017 u jep mundësi institucioneve të rivlerësimit për të arritur në përfundimin nëse është bërë deklarin i saktë ose i pasaktë i pasurisë, është bërë ose jo fshehje e kësaj pasurie, nëse është i justifikuar burimi i të ardhurave dhe pasurisë së deklaruar etj. Për sa më sipër, nuk qëndron pretendimi i ankuesit.

44. Parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (nenet 25, 27 dhe 28) ishin të tilla që i njihnin pasaktësitë dhe lapsuset (ato janë deklaruar si të tilla nga subjekti) në deklarinet e pasurisë, madje deri në një vlerë prej 2.000.000 (dy milionë) lekësh në deklarinet periodike dhe 3.000.000 (tre milionë) lekësh në deklarinet për herë të parë. Për sa kohë që pasaktësitë e konstatuara janë pranuar nga subjekti i rivlerësimit, ato nuk mund të konsiderohen si deklarin i rremë, pasi mungon dashja apo qëllimi për të bërë deklarin të rremë, mungon gënjeshtër lidhur me pasaktësitë e konstatuara nga Komisioni, kjo nisur edhe nga bashkëpunimi që ka shfaqur subjekti gjatë gjithë procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, mungon dashja e subjektit për të kryer fshehje apo deklarin të rremë, e për pasojë nuk përbën sens realizimi i anës subjektive.

Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se është e vërtetë që dispozitat që përmend ankuesi si më sipër u njihnin të drejtën subjekteve deklaruuese që të ndreqnin gabimet apo lapsuset në deklarinet, por në rastin konkret subjekti i rivlerësimit në asnjë moment,

duke nisur nga deklarimi i pasurisë “vetting” 2017, si dhe në asnjë nga deklaratimet periodike apo në deklaratimet para ILDKPKI-së ndër vite nuk i ka ndrequr këto “gabime njerëzore” apo “lapsuse”, siç pretendon ai, porse me dashje ka lejuar që ato të qëndrojnë të tilla në deklaratimet e tij, duke sjellë pasojat përkatëse. Kjo formë e dashjes së subjektit shfaqet si dashje eventuale (indirekte - dollus eventualis). Për sa më sipër, nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.

45. Për sa i përket mospërputhjes së deklaratimeve të subjektit në çmim dhe në sipërfaqe të apartamentit të banimit, me sipërfaqe 145 m², i ndodhur në rr. “{***}”, pallati nr. 1, apartamenti 13, Tiranë, janë thjesht gabime apo lapsuse njerëzore.

Lidhur me pretendimin e subjektit se gabimet në deklaratimet e tij, në çmim dhe në sipërfaqe, për pasurinë në fjalë, janë lapsuse, trupi gjykues çmon se këto pasaktësi kanë pasur qëllim që subjekti të fshehë pasuritë e deklaruar. “Lapsus”, siç pretendon subjekti, nuk mund të quhen pasaktësitë e përsëritura në çdo pasuri të deklaruar në deklaratimet e tij periodike dhe në deklaratën e pasurisë “vetting” 2017.

46. Lidhur me ambientin hapësirë prej 132 m², rruga “{***}”, në shumën 5,8 milionë lekë, deklarim i vitit 2003, dhe në deklarimin për efekt të vetting-ut është deklaruar shuma 5 milionë lekë. Sa i takon burimit për blerjen e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit deklaroi se burimi është i ligjshëm. Pasaktësitë në deklarim janë lapsuse apo pakujdesi nga ana e subjektit. Lidhur me lotarinë sportive në atë kohë, djali i subjektit ka qenë i mitur dhe nuk kishte ligj të specifikuar për ndalesën e të miturve. Lidhur me detyrimet që iu kishte shtetasve H.D. dhe B.XH., nuk janë detyrime që janë përdorur për blerje dyqani, por janë përdorur si garanci për nxjerrjen e vizës së vajzës A.K.. Dyshimi për mosshlyerje të këtyre detyrimeve është sqaruar në deklaratën që ka bërë subjekti në procesverbalin e deklarimit, datë 18 janar 2016, para ILDKPKI-së.

Lidhur me burimin, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se e ka blerë këtë hapësirë me të ardhurat nga paga e tij, nga paga e bashkëshortes, lotaritë sportive të fituara nga djali dhe shitja e shtëpisë në Elbasan, ndërkohë që në deklaratën e pasurisë “vetting” 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka blerë këtë pasuri vetëm me të ardhurat nga shitja e shtëpisë në Elbasan.

Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit deklaroi se burim të ardhurash për blerjen e kësaj pasurie vetëm të ardhurat nga lotari sportive, për të cilat ankuesi pretendon të jenë fituar nga djali i tij E.K., i cili ka qenë i mitur në momentin e fitimit (17 vjeç), por në atë kohë nuk ka pasur një ligj për lojërat e fatit dhe në këtë mënyrë nuk ka qenë e ndaluar për fëmijët e mitur që t’i luanin ato. Lidhur me këtë pretendim në ankim, theksojmë se subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këto ardhura nga lotaritë sportive si të ardhura të krijuara nga vetë ai në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, duke konfirmuar të njëjtin deklarim në deklaratën e pasurisë “vetting” 2017, ndërkohë që në ankim ai pretendon se këto të ardhura janë krijuar nga lotaritë sportive të fituara nga i biri, E.K.. Gjithashtu, duke qenë se biletat e lotarive sportive nuk kanë gjeneralitete, nga të cilat të mund të identifikohet fituesi, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë përkatësinë dhe ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Për këtë arsye, nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.

Gjithashtu, ka mospërputhje mes deklaratës së pasurisë “vetting” 2017 dhe asaj të vitit 2003, ku në të parën deklaroi se burim vetëm të ardhurat nga shitja e shtëpisë në Elbasan, ndërkohë në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 të ardhurat nga lotaria sportive dhe dy hua në vlerën totale 2.200.000 lekë (1.500.000 lekë dhe 700.000 lekë), të cilat nuk janë përmendur më në deklaratimet periodike të pasurisë. Lidhur me këto hua, subjekti pretendon në ankim që i ka përdorur si garanci për nxjerrjen e vizës për studimet e vajzës në Itali, por ai nuk arriti të provojë se në cilin institucion

financiar, vendas apo të huaj, i ka depozituar këto vlera në formë garancie dhe si i ka kthyer ato te huadhënësit. Sa më sipër, ngelën të paprovuara nga ankuesi.

Lidhur me çmimin e blerjes së hapësirës 132 m², subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë “vetting” 2017 ka deklaruar 5.000.000 lekë, ndërsa në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 ka deklaruar 5.800.000 lekë, ndërkohë që kontrata e sipërmarrjes e datës 06.01.2003, vërtetuar nënshkrimi nga notere M.XH., me nr. *** rep., datë 17.03.2003, dërguar Komisionit me shkresën e noteres M.XH. të protokolluar në Komision me nr. 464/4 prot., datë 27.02.2018, lidhur midis sipërmarrësit V.P., në cilësinë e investitorit të shoqërisë “{***}” SHPK dhe bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, L.K., në cilësinë e porositëses, parashikon në nenin 2: “Çmimi i plotë i këtij dyqani është (Dhurim)”, kurse në nenin 3 të saj: “Sipërmarrësi V.P. deklaroi se e ka dhuruar këtë dyqan”. Pra, në analizë të deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë “vetting” 2017, deklaratës së vitit 2003, si dhe të shpjegimeve të dhëna prej tij para Komisionit, rezulton që përveç faktit se bashkëshortja e tij ka lidhur një kontratë fiktive, subjekti i rivlerësimit ka pranuar gjithashtu se nuk ka thënë të vërtetën lidhur me çmimin e pasurisë.

Për gjithë sa më sipër, është i drejtë vendimi i Komisionit kur konkludon se, referuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të kësaj pasurie, si edhe ka bërë përpjekje për të fshehur ose pasqyruar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij në përputhje me nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës.

47. Komisioni duhet t’i kalonte subjektit të rivlerësimit barrën e provës ose të hetonte rreth kontratave të ngjashme në tregun e shtëpive në Elbasan në momentin e shitjes së banesës. Në lidhje me vlerën e shitjes së apartamentit në Elbasan, subjekti pretendon se ajo është aq sa ka pohuar në deklaratën e vitit 2003, pra 4,8 milionë lekë. Ai mendon se vlera e përcaktuar në kontratë është lapsus i noteres, as që mendohej që një banesë e tillë të shitej për kohën në atë shumë.

Nga aktet që gjenden në dosje rezulton të ketë një vendim të trupit gjykues nr. 04 të Komisionit, vendimi nr. 02, datë 29.05.2018, i cili i ka dhënë fund hetimit kryesisht vetëm për kriterin e pasurisë, si dhe ka vendosur të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit vetëm për kriterin e pasurisë, në bazë të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, por nuk ka kalim të barrës së provës lidhur me këtë kontratë shitblerjeje. Gjithsesi, vlerësojmë se edhe në rast se subjektit do t’i kalonte barra e provës për të vërtetuar që ai e kishte shitur këtë shtëpi me vlerë të ndryshme nga ajo e parashikuar në kontratë, pra të ndryshme nga vlera 200.000 lekë, konkretisht në vlerën 4.800.000 lekë, siç pretendon ankuesi të ketë qenë vlera reale e shitjes, në këtë rast do të kishim të bënim me përfshirjen e tij në evazion fiskal, pasi ai me dashje ka vendosur në kontratë një vlerë shumë të vogël për të mos paguar detyrimet përkatëse tatimore për shitjen e shtëpisë. Lidhur me pretendimin në ankim të subjektit se ky titull kontrate (“Kontratë sipërmarrjeje”) ishte sugjeruar nga noterja, vlerësojmë se nuk është i vërtetë, pasi kontrata nuk është lidhur para noterit, por mes palëve, ndërkohë që para noterit është bërë vërtetimi i nënshkrimit pas më shumë se dy muajsh (06.01.2003 – 17.03.2003).

48. Raporti i paraqitur nga ILDKPKI është raport i paracaktuar, është akt tendencioz dhe aspak profesional dhe nuk duhet të ishte marrë si provë në procesin e kontrollit dhe rivlerësimit të tij.

ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të kontrollit përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, e sipas rastit, konstaton se deklarimi është i saktë në

përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare, nuk gjendet në situatë konflikti interesi, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, është kryer fshehje e pasurisë, është kryer deklarim i rremë apo subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit. Pra, nisur nga kjo dispozitë, ILDKPKI-ja është e detyruar të paraqesë raport të hollësishëm për deklaratimet periodike dhe atë “vetting” për subjektin, pasi është detyrim ligjor. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklaratimit, sipas ligjit. Komisioni në analizën e tij ka marrë në cilësinë e provës deklaratimet periodike të subjektit të rivlerësimit dhe atë “vetting”.

49. Nuk është kompetencë e ILDKPKI-së dhe as e Komisionit të shprehen për fiktivitetin ose pavlefshmërinë e kontratave (rasti i kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2000, me palë blerëse A.K. dhe palë shitëse shoqëria {***} SHPK), ajo është kompetencë vetëm e gjykatës.

*Trupi gjykues vlerëson se në vendimin e Komisionit nuk gjendet asnjë konkluzion i tillë, i cili ka analizuar ose ka deklaruar fiktive kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2000 të lidhur mes shtetasit A.K. dhe shoqërisë {***} SHPK. Për sa më sipër, nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.*

50. Komisioni nuk duhet të ketë standard të dyfishtë në shqyrtimin e çështjeve, siç është rasti i dy anëtarëve të Gjykatës së Lartë (çështja D. dhe çështja Z.), çështjet e të cilëve u shqyrtuan menjëherë pas subjektit të rivlerësimit, me të njëjtët komisionerë dhe me të njëjtat problematika mbi lapsuse kontraktuale, të cilët u rikonfirmuan në detyrë nga Komisioni. Kjo është arsyeja që Komisioni po përdor standard të dyfishtë.

Kolegji është një nga institucionet e rivlerësimit. Ai shqyrton ankimet e subjekteve të rivlerësimit dhe Komisionerëve Publikë rast pas rasti, duke përdorur të njëjtin standard gjykimi.

51. Në përfundim, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, mbi bazën e parimeve të barazisë para ligjit, kushtetutshmërisë, ligjshmërisë e proporcionalitetit, parime këto që garantojnë të drejtën e subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, bazuar në arsyet e parashtruara më lart, vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 33, datë 05.07.2018, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mbështetur në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 33, datë 05.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Luan Kaloçi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
3. U shpall sot, në Tiranë, më datë 23.10.2018.

RELATORE

Natasha MULAJ
nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ
nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA
nënshkrimi

ANËTAR

Luan DACI
nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI
nënshkrimi